



Data: 14.06.2018

Ref.: 664/10D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 56-të, të mbajtur më 11 Qershor 2018, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji "Dardania":

- Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Dardania" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale	BA	180	Arlinda Arenliu, Bilall Lutfiu, Lulzime Kadriu

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin "Dardania" më 07.12.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol dhe Anita Trnavcevic.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 11 Qershor 2018 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji "Dardania", dhe ka konsideruar se raporti i hartuar nga ekspertet ka qenë jo bindës, dhe kështu ka votuar për mos akreditimin e programit Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale BA.

Anëtarët e KSHC-së kanë konsideruar se raporti i ekspertëve ka mungesë të konsistencës dhe se përmbajta e raportit nuk korrespondon me rekomandimin përfundimtarë. Ata kanë analizuar në mënyrë të veçantë stafin akademik bartës të programit dhe ka ardhur në përfundim se asnjëri nga ta nuk ka PhD nga fusha e Punës Sociale sipas kodit ESAC 14.5

Përmbajtja e programit (kurrikula), literatura e mangët në gjuhën shqipe, mungesa e librave të mjaftueshëm në bibliotekë për programin specifik, mungesa e stafit të dedikuar në mënyrë specifike për këtë program, mungesa e aktiviteteve hulumtuese, si dhe mungesa e internacionalizimit dhe me theks të veçantë shkëmbimit të studenteve dhe stafit janë gjetjet kryesore të raportit, të cilat KSHC i ka konsideruar si thelbësore, duke refuzuar kështu akreditimin e këtij programi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Dardania";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

